

URDHËR
Nr. 37, datë 24.2.2023

PËR DELEGIM TË PËRKOHSHËM KOMPETENCASH

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 17 dhe 21, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenit 17, pika 2, germa “k”, e rregullores “Për organizimin e funksionimit të personelit dhe administrimin e dokumentacionit Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, të ndryshuar, neneve 9, 15 dhe 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të udhëzimit nr. 7, datë 28.2.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, për shkak të lejes vjetore të Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit;

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të Sekretarit të Përgjithshëm të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
2. Delegimin e kompetencave, si nëpunës autorizues, për kryerjen e pagesave për të gjithë zërat e shpenzimeve (paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime), znj. Manjola Kelolli, drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun.
3. Delegimin e kompetencave të mësipërme për periudhën 2.3.2023–8.3.2023.
4. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohet drejtori i Drejtorisë së Menaxhimit të Çështjeve dhe Marrëdhënieve me Median dhe Publikun, znj. Manjola Kelolli.
5. Znj. Manjola Kelolli nuk mund ta nëndelegojë këtë kompetencë.
6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen të gjithë punonjësit e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Laerta Rooze